



Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-60351

Dt. 25.06.2026

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR KK – PRIZREN, me kërkesën e **Fejzula dhe Fluter Mulamisini** me banim në rrugën “Shkelzen Dragaj” nr. 18 me numër të kërkesës **04-353/01-60351** në bazë të nenit 3.paragrafi 1.11 si dhe nenit 5 paragrafi 1 Pika 1.3 e në kuptim të nenit 14 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenit 15 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 19 paragrafi 2 të Ligjit për Ndërtim Numër 04/L-110 si dhe konform dispozitave të neneve 26 paragrafi 1, nenet 27, 44, 46, 47, 48 dhe 86,125 dhe 127 të Ligjit për Procedurën Përgjithshme Administrative-LPPA-së numër 05/L-031, e lidhur me dispozitat e neni 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022-2030 Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. **LEJOHET: Fejzula dhe Fluter Mulamisini** me banim në rrugën “Shkelzen Dragaj”nr.18 në zhvillimin e punimeve: **Renovimin e brendshëm dhe të jashtëm si dhe ndërtimin e kulmit të objektit – Shtëpi individuale**, e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-04452-2 Z.K. Prizren**, në rrugën “**Bajrije Bahtjari**” nr. 165 e cila është e identifikuar sipas kopjes së planit.

II. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë të punuar nga ana e byros projektuese “Standard Projekt”P.P. (gjendja e re dhe gjendja ekzistuese).

III. Gjatë renovimit nuk lejohet kurrfarë ndryshimi në etazhitet të objektit ,e në sipërfaqen e gabaritit të objektit.

IV. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.

V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se: me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik i **Fejzula dhe Fluter Mulamisini**, nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për renovimin e objekteve të K Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për :

Renovimin e brendshëm dhe të jashtëm si dhe ndërtimin e kulmit të objektit – Shtëpi individuale, e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-04452-2 ZK Prizren**.

Nga se u tha më lartë u murr aktvendimi si në dispozitiv.


KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPH-së në Prishtinë, përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional:


Xhejlane Gjini, inxh. dip. ark.



DREJTORI:


Florent Ukaj, ecc i dip.

